



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I BASHKISE KORCE

VENDIM
Nr 27 Date 02.09.2009

Për miratimin për kalimin në privatizim të banesave shtetërore

Këshilli i Bashkise Korçë, në mbledhjen e tij të dates se sotme pasi mori në analize relacionin e paraqitur nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, "Për kalim në privatizim", mbështetur në Ligjin Nr. 8122 datë 09.07.1996 "Për miratimin pa ndryshime të dekretit të Presidentit Nr. 1440 datë 04.04.1996 "Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara". Banesat shtetërore që nuk janë privatizuar deri më datën 31.12.1995 dhe që nuk janë objekt i Ligjit 7658 datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompesimin e pronës", kalojnë në administrimin e organeve të pushtetit lokal në Komuna dhe Bashki, sipas vendodhjes së banesës si dhe neni 2 i cili parashikon se "Këshillat e Bashkive ose Komunave në varësi nga vendodhja, do të vendosin për privatizimin e tyre sipas kriterëve të Ligjit Nr. 7652 datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", ku sipas të cilit është Këshilli i Bashkise që vendos për miratimin e kalimit në privatizim si dhe duke u mbështetur dhe në vendimin e Bashkisë Korçë Nr. 97 datë 11.09.2000 pika 1, mbështetur në kopetencat që ka si dhe pas diskutimeve të anetareve:

V E N D O S I

1. Te kalojë në privatizim banesa një katëshe e ndodhur në rrugën "Naum Karanxha" Lagje nr 4, e përberë prej 2 dhoma me sip ndërtimi 47.68 m2 dhe sip trotuari 4.44 m2, në të cilin banon familja e Nexhat Shkëmbi.
2. Të bëhet kalimi i kontratës së qira banese nga Nexha Çobani i cili ka ndruar jetë më 28.11.1997 në Pellumb Çobani (i biri) i cili banon në këte banese e ndodhur në Rr "Kajo Karafili nr 3 dhe paguan qira banese në emrin e babajt të tij.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

RAIMONDA NASE

Raimonda Nase